



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2026

Shtojca 12.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 04/08/2026

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE)

☐

ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) X

“NIEM” Shpk, me Nuis K36609610Q dhe me adrese Autostrada Bilisht Korce, Km. i 3, Qender Bilisht, Bitincke, Korce & “UDHA” Shpk, me Nuis K77524909Q dhe me adrese Lagjja “Pjeter Budi”, Rruga “Qamil Xhika”, Ndertesa Nr.31 8001, Burrel, Diber.

- OE “NIEM” Shpk, me pjesëmarrje prej 98 %
- OE “UDHA” Shpk, me pjesëmarrje prej 2 %

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO **X**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO **X**

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-92688-07-07-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i kanalit ujites dega kryesore Koterr-Kakarriq, segmenti Gjader-Gocaj, Bashkia Lezhe Loti II-te”.

Kohëzgjatja e kontratës: 6 Muaj nga data e nënshkrimit te Kontrates.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 08/07/2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 45, datë 13 Korrik 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1- Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” Shpk, me Nuis K53002402C dhe me oferte ekonomike 39,571,098 (tridhjetë e nente milion e pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nentëdhjetë e tete) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 2- Operatori Ekonomik “INA” Shpk, me Nuis J61814009W dhe me oferte ekonomike 31,957,790 (tridhjetë e një milion e nentëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e nentëdhjetë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “NIEM” Shpk, me Nuis K36609610Q & “UDHA” Shpk, me Nuis K77524909Q dhe me oferte ekonomike 35,714,543 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e katërmëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) Lek pa Tvsh,

OE “NIEM” Shpk, me pjesëmarrje prej 98 %

OE “UDHA” Shpk, me pjesëmarrje prej 2 %

-OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

- 4- Operatori Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K dhe me oferte ekonomike 40,280,709 (dyzet milion e dyqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e nente) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “INA” Shpk, me Nuis J61814009W,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE ka dorezuar te gjithë dokumentacionin ne perputhje me kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit te percaktuar ne dokumentat standarte te tenderit.

Komisioni i vleresimit te ofertave mbeshtetur në nenin 92, pika 3, ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, ku parashikohet shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Per sa me siper oferta e dorezuar nga OE “INA” Shpk, me Nuis J61814009W, eshte kualifikuar paraprakisht.

- I. Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE ka vendosur te kualifikoje paraprakisht oferten e paraqitur nga “INA” SH.P.K, me Nuis J61814009W.*
- II. KVO ne daten 24.07.2026, pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur ne SPE, i kerkoi Operatorit Ekonomik OE “INA” SH.P.K, me Nuis J61814009W, te klasifikuar paraprakisht i pari, te dorezoje dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, të nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik” te ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike per proceduren e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i kanalit ujites dega kryesore Koterr-Kakarriq, segmenti Gjader-Gocaj, Bashkia Lezhe Loti II-te”, me date 23.07.2026,*

.... dhe bazuar ne piken 1 dhe 5, te nenit 82, te Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

si dhe bazuar piken 1 dhe 6 te nenit 26, te VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin.

Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

KVO verën se pas njoftimit nga ana e AK-se për dorezimin e dokumentacionit provues është paraqitur OE “INA” SH.P.K, me Nuis J61814009W, dhe ka dorezuar me datë 28.07.2026 pranë Bashkisë Lezhë dokumentacionin fizik të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike me datë 23.07.2026.

Sa me sipër, Komisioni i Vleresimit të Ofertave pas **kualifikimit paraprakisht** të Dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, si dhe pas marrjes në dorezim të dokumentacionit fizik të dorezuar pranë Bashkisë Lezhë me shkresën nr. 15223 protokollin hyrës, me datë 28.07.2026 nga OE “INA” SH.P.K, me Nuis J61814009W, si dhe bazuar në nenin 82, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2022 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar ku konstatoi se:

Se pari, nuk plotëson kriterin 2.3.5 të DST-se ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomikë duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

- Teknik Ndertimi/ Gjeometer	2 (dy)	Diplome shkolle mesme
- Teknik Topograf	1 (një)	Diplome shkolle mesme
- Betonues	5 (pese)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Saldator	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Karpentier	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Hidroizolues	1 (një)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Punonjes për prerje bimesh	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Dëshmi profesionale
- Shofer	4 (kater)	Leje Drejtimi
- Manovrator	4 (kater)	Dëshmi e Aftësisë Profesionale (DAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin e mesipër: Kontratat individuale të punës, Diplome të shkolle mesme/ Certificate Trajnimi / Certificate të Aftësisë Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesipërme të figurojë në listet pagesat e shoqërisë për periudhën Mars 2026 – Maj 2026.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/dëshmitë/certifikatat) që nuk janë lëshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të

metejshme sipas parashikimeve perkatase te ligjit te prokurimit publik.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesis ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatase te DST-se dhe tabelës se mesiperme, te cila duhet te dorezohet ne fazen e ofertimit ne SPE. Ndersa dokumentacioni provues i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit paraprak dhe fillimit te afateve te ankimit.

KVO verën se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatase te DST-se, te dhenat e stafit mbeshettes qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.5 te DST-se.*

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “INA” SHPK rezulton se ky subjekt nder te tjera per permbushjen e kriterit 2.3.5 te DST-se ka deklaruar si me poshte:

- Z..G. Korra **me profeson kopshtar/punonjes per prerje bimesh**, i punesuar prane shoqerise sone ne rolin e kopshtar/punonjes per prerje bimesh.
- Z..B. Gjoli **me profeson kopshtar/punonjes per prerje bimesh**, i punesuar prane shoqerise sone ne rolin e kopshtar/punonjes per prerje bimesh.
- Z. V. Canaliaj **me profeson Manovrator Eskavatorist, i kontraktuar me mjetin**
- Z. D. Kamberi, **me profeson Shofer, i kontraktuar me mjetin**
- Z. T. Bliu , **me profeson Shofer, i kontraktuar me mjetin**

I. Ne lidhje me deklarimin per disponimin e 2 (dy) Punonjes per prerje bimesh te pajisur me Certificate Trajnimi/ Deshmi profesionale KVO verën se:

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE, verëhet se operatori ekonomik ne deklaraten per stafin mbeshettes **2 (dy) Punonjes per prerje bimesh**, ka deklaruar se disponon deshmi profesionale per “**Punonjes per prerje bimesh**”, te leshuar nga subjekti “Agjencia Shqiptare e Punësimit” Shpk, me Nuis L21410066G, i cili ky i fundit nuk eshte i pajisur me license per formim

profesional per ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjesve te fushave **“Punonjes per prerje bimesh”** dhe per rrjedhoje nuk mund te trajnoje dhe certifikojë punonjesit e kerkuar ne DST.

Po ashtu, KVO verën se edhe ne dokumentacionin e paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K konstatohet se nga ky OE janë paraqitur **Certifikate Trajnimi/ Deshmi profesionale te leshuar nga subjekti** “Agjencia Shqiptare e Punësimit” Shpk, me Nuis L21410066G i cili ky i fundit nuk është i pajisur me license per formim profesional per ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjesve te fushave **“Punonjes per prerje bimesh”** dhe per rrjedhoje nuk mund te trajnoje dhe certifikojë punonjesit e kerkuar ne DST.

Nga analizimi i kriterit 2.3.5, vërehet se nder te tjera është sqaruar ne menyre te vecante kërkesa qe stafi mbështetet te jete i certifikuar sipas legjislacionit te arsimit profesional konkretisht si me poshte vijon:

“V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk është leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta....”.

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne pikat 5 dhe 6, të Nenit 20, të Ligjit Nr. 10081, datë 23.02.2009, *“Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”*, të pikës 5 Kreu II , VKM Nr.538, datë 26.05.2009 *“Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta”*, i ndryshuar, të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit, nr.1457, datë 28.07.2009 *“Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licensim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional”*, i ndryshuar, subjektet qe plotesojne kriteret per ofrimin e kurseve te formimit profesional duhet te paraqesin kerkese per licensim per llojin e formimit profesional dhe pas miratimit te kerkeses dhe publikimit ne qkb.gov.al mund te vijojne me trajnimin dhe certifikimin e qytetareve qe shprehin interes per kete sherbim.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave rithekson bindjen e tij se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i plotesimit te kriterëve te vecanta te paraqitura ne DST, per tu permbushur njesoj nga te gjithë Operatorët Ekonomik pjesemarrës është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjmerine dhe efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si **lex specialis** mbi lëndën.

Theksojme se ushtrimi i aktivitetit te formimit profesional pa u pajisur paraprakisht me licensen perkatese është ne kundërshtim me percaktimet ligjore dhe mund te sjelle pasoja te qytetaret qe kerkojne te perfitojne nga formimet profesionale pasi subjektet qe nuk jane pajisur me licensen per formim profesional nuk i jane nenshtruar kontrollit te institucioneve shteterore mbi kapacitetin per ofrimin e formimit profesional.

Sa me siper nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE dhe ne web qkb.gov.al, rezulton se subjekti “Agjencia Shqiptare e Punësimit” Shpk, me Nuis L21410066G, nuk është i pajisur me license per formim profesional per ofrimin e kurseve dhe certifikimin e punonjesve ne fushen **“Punonjes per prerje bimesh”** dhe per rrjedhoje operatori ekonomik ofertues nuk disponon ne stafin mbështetes

2 (dy) punonjes “*Punonjes per prerje bimesh*”, te pajisur me deshmi profesionale te leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional duke mospermbushur kete kriter.

Si perfundim KVO konstaton se Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K nuk permbush kriterin 2.3.5, te DST-se ne lidhje me disponimin e 2 (dy) punonjes “Punonjes per prerje bimesh”.

II. Ne lidhje me deklarimin per disponimin e 4 (kater) shofer dhe 4 (kater) manovrator KVO veren se:

Bazuar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit te paraqitur prane Bashkise Lezhe nga Operatori Ekonomik “INA” SHPK rezulton se ky subjekt nder te tjera per permbushjen e kriterit 2.3.5 te DST-se per diponimin e shoferave dhe manovratoreve ka deklaruar si me poshte:

- Z. V. Canaliaj me profesion **Manovrator** Eskavatorist, **i kontraktuar me mjetin**
- Z. D. Kamberi, me profesion **Shofer, i kontraktuar me mjetin**
- Z. T. Bliu , me profesion **Shofer, i kontraktuar me mjetin**

KVO mban ne konsiderate se Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: **Kontratat individuale te punës**, Diplome e shkolles mesme/ Certificate Trajnimi / **Certificate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi** sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm **te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026.**

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se Z. V. Canaliaj, Z. D. Kamberi dh Z. T. Bliu nuk figurojne ne listepagesat e shoqerise “INA” SH.P.K per periudhen Mars 2026 – Maj 2026.

Po ashtu, nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe rezulton se **Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K nuk ka lidhur asnje kontrate individuale te punes me Z. V. Canaliaj, Z. D. Kamberi dh Z. T. Bliu dhe per rrjedhoje keta punonjes nuk jane te punesur prane ketij OE.**

KVO mban ne konsiderate se bazuar ne dokumentacionin e paraqitur prane Bashkise Lezhe nuk rezulton se ky subjekt te kete dorezuar ndonje marreveshje bashkepunimi si Bashkim Operatoresh Ekonomik (BOE) apo te kete deklaruar subjekt mbetetes per kete procedure prokurimi.

KVO veren se OE “INA” SHPK ka paraqitur kontrate qiraje per mjetet e marre me qira nga subjekti “INERTI” SH.P.K **i cili nuk eshte as ne rolin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike dhe as ne rolin e subjektit mbeshtetes.**

Po ashtu, KVO veren se per Z. V. Canaliaj, Z. D. Kamberi dh Z. T. Bliu ka paraqitur kontratat e punes te lidhur me Subjektin “INERTI” SHPK te cilet kane rene dakord te punojne per kete subjekt.

KVO mban ne konsiderate se cdo marreveshje per ndryshimin e vendit te punes apo punedhenesin pa pelqimin e punemarresit eshte absolutisht e pavlefshem dhe bie ndesh me dispozitat e ligjit te nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Per sa me lart, konstatohet se Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K nuk disponon te punesuar dhe te deklaruar ne listpagesat e shoqerise per periudhen Mars 2026 – Maj 2026 punonjesit Z. V. Canaliaj, Z. D. Kamberi dhe Z. T. Bliu, dhe per me teper konstatohet se per keta punonjes pa marre pelqimin e tyre eshte angazhuar me nje subjekt tjetër per lidhjen e marredhenies se punes ne kundershtim te hapur te ligjit te nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Per sa cituam me siper, si dhe bazuar ne dokumentacionin e dorezuar prane Bashkise Lezhe rezulton se ky subjekt ka deklaruar te dhena te paverteta per qellime kualifikimi ne lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore ne marredheniet e punes ku verehet se ka deklaruar si me poshte:

“D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

- ***Operatori ekonomik INA SHPK garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.***
- ***Operatori ekonomik INA SHPK lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.***
- ***Operatori ekonomik INA SHPK nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH”.***

Referuar sa me lart KVO, bazuar ne dokumentacionin (Manovrator i kontraktuar me mjetin Shofer, i kontraktuar me mjetin) e paraqitur prane Bashkise Lezhe nga OE “INA” SH.P.K, konstaton se ky operator ekonomik eshte shkeles i legjislacionit te punes.

Per sa me lart Komisioni i Vleresimit te ofertave vlereson se OE “INA” SH.P.K eshte ne situaten e shkeljes së detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin e punës te parashikuar ne nenin 76, pika 3, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ne te cilin citohet se: “Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, **të punës**, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

Sa me siper nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur prane Bashkise Lezhe, KVO konstaton se operatori ekonomik “INA” SH.P.K, ka paraqitur dokumentacion provues te sakte vetem per:

- 3(tre) manovratore nga 4 (kater) te kerkuar, ndersa per 1 (nje) manovratore tjetër nuk rezulton i punesuar dhe i deklaruar ne listpagesat e shoqerise “INA” SH.P.K per periudhen Mars 2026 – Maj 2026,
- 2 (dy) shofere nga 4 (kater) te kerkuar, ndersa per 2 (dy) shofere te tjere nuk rezultojne te punesuar dhe te deklaruar ne listpagesat e shoqerise “INA” SH.P.K per periudhen Mars 2026 – Maj 2026,

Si perfundim KVO konstaton se Operatori Ekonomik “INA” SH.P.K nuk permbush kriterin 2.3.5, te DST-se ne lidhje me disponimin e 4 (kater) Shoferave dhe 4 (kater) Manovratorave dhe njekohesisht eshte ne shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin e punës.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.7, ku parashikohet se: “Operatoret Ekonomike duhet te disponoje mjetet e meposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Forma e disponimit</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 – 15 ton</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>2</i>	<i>Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 8 – 10 ton</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>3</i>	<i>Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3 ton</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>4</i>	<i>Autovinç</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>5</i>	<i>Ekskavator me zinxhir</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>6</i>	<i>Ekskavator me goma</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>7</i>	<i>Minieskavator</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>8</i>	<i>Autobetoniere</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>9</i>	<i>Autopompe betoni</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>10</i>	<i>Autobot uji</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>11</i>	<i>Betoniere kantieri</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>12</i>	<i>Saldatrice</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>13</i>	<i>Tokmak Elektrik</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>14</i>	<i>Vibratorë</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>
<i>15</i>	<i>Helikopter nivelues</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
<i>16</i>	<i>Aparat topogjeodezik me GPS</i>	<i>Ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>

Gjithashtu ne zbatim te VKM-se Nr.312, date 05.05.2010, operatori ekonomik pjesemarres duhet te disponoje mjete dhe pajisje mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit, si me poshte:

- Kokore – jo me pak se 27 cope
- Jeleke – jo me pak se 27 cope
- Prozhektore ndriçimi naten – jo me pak se 10 cope

- *Komplet i ndihmes se shpejte – jo me pak se 2 cope*
- *Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra – jo me pak se 2 cope*
- *Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt – jo me pak se 10 cope*

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - **siguracionin**; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.*
- *Ndersa per mjete te marra me qera/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase/ bashkëpunimit.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera/ Kontrate bashkëpunimi, krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qeras/ Kontrate Bashkepunimi.*

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

KVO veren se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e mjeteve qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.7 te DST-se.*

KVO mban ne konsiderate se per te deshmuar plotesimin e kriterit 2.3.7, te DST-se, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - **taksat vjetore**- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe te jetë e dukshme targa e mjetit.

Per sa me lart, Komisioni i Vleresimit te Ofertave pas **kualifikimit paraprakisht** te Dokumentacionit te paraqitur ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, si dhe pas marrjes ne dorezim te dokumentacionit fizik te dorezuar prane Bashkise Lezhe nga OE “INA” SH.P.K, me Nuis J61814009W, si dhe bazuar ne nenin 82, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2022 “Per miratimin e rregulave te prokurimit publik” te ndryshuar, mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar ne lidhje me mjetet qe disponon sipas percaktimeve te pikes 2.3.7 te DST-se ku konstatoi se:

- I. Per mjetin e deklaruar “*Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3 ton*”, me targe AA260GC, nuk ka paraqitur dokument per pagesen e takses vjetore te mjetit.
- II. Per mjetin *Kamionin vetëshkarkues*, me targe AA083GB, ka paraqitur dokument per pagesen e kesaj takse te leshuar me daten 27.07.2026 nderkohe qe data e zhvillimit te procedures eshte me date 23.07.2026.
- III. Per mjetin *Eskavator me goma*, me targe ARMT83, ka paraqitur document per pagesen e kesaj takse te leshuar me daten 27.07.2026 nderkohe qe data e zhvillimit te procedures eshte me date 23.07.2026.

KVO mban ne konsiderate se bazuar në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 6, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik i cili pas fazës së vlerësimit kualifikohet i pari duhet që përpara publikimit të njoftimit të fituesit e nisjes së afateve të ankimit, të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të aktit rregullator të sipërcituar të cila janë deklaruar në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, **dhe çfarë është e rëndësishme këto dokumenta duhet të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.**

Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton se me datë 23.07.2026 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit që do të thotë ka hapur për vlerësim ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Referuar parashikimeve më sipër të aktit rregullator dokumentet provues të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duhet të provojnë gjendjen faktike të subjektit në momentin e ofertimit pra me datë **23.07.2025**, datë në të cilën janë hapur për vlerësim ofertat.

Nga verifikimet e dokumenteve provuese të cilët janë deklaruar në shtojcën 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe të dorëzuara në autoritet kontraktor nga operator ekonomik “INA” SHPK si i kualifikuar i pari rezulton se dokumentacioni provues i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të 22 pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, i ndryshuar që provon deklarimet e bëra për përmbushjen e kritereve të përgjithshme për kualifikim rezulton se mban datën 27.07.2026, pra të një datë të mëvonshme se sa ajo e hapjes së ofertave me 23.07.2026.

Në këtë **kuadër Komisioni konsaton se lidhur me dokumentacionin provues për deklarimin e datës 23.07.2026** të bërë nga operatori ekonomik “INA” SHPK në Pjesën II, “Shkaqet e përjashtimit”, Pika A “Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit” **nuk është i vlefshëm për përmbushjen e deklarimeve të bërë në datën 23.07.2026, pasi në këtë datë këto dokumenta nuk ishin lëshuar akoma nga organet kompetente dhe deklarimet e datës 23.07.2026 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk mund të provohen me dokumentacion që nuk ka ekzistuar në këtë datë, pra në datë e hapjes së ofertave.**

KVO thekson, se **operatori ekonomik “INA” SHPK duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit** nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve **me datë lëshimi para hapjes së ofertave** dhe si rrjedhim duhet të dorëzonte dokumentacionin e cituar më sipër në këtë vendim (dokumentacioni provuese i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar) me datë lëshimi të dokumentave jo më vonë se me datë 23.07.2026. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. **Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë.** Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore

Per me teper konstatohet se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ka mbajtur te njejten qendrim dhe ka detyruar Bashkine Lezhe te rivleresoje procedure e prokurimit duke mbajtur ne konsiderate konstatimet e mesiperme.

Theksojme se Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin **Nr. 1235/2025** ka mbajtur te njejtin qendrim ku nder te tjera gjykon se *“KPP gjykon, se operatori ekonomik “Information Business System-IBS” SHPK duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor në sistemin elektronik të prokurimeve me datë lëshimi para hapjes së ofertave dhe si rrjedhim duhet të dorëzonte dokumentacionin e cituar më sipër në këtë vendim (dokumentacioni provuese i parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar) me datë lëshimi të dokumentave jo më vonë se me datë 12.05.2025. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Nuk mund të lejohet paraqitja e asnjë dokumenti tjetër pas mbarimit të afatit për hapjen e ofertave, pasi një gjë e tillë do të konsiderohej ndërhyrje në ofertë. Vlerësimi i dokumentacionit, i cili do të sigurohej në të ardhmen nga operatorët ekonomikë, do të cenonte në thelb konceptin e prokurimit publik, i cili i nënshtrohet afateve të përcaktuara procedurale ligjore*

KPP nuk mund të vlerësojë një fakt apo dokument të ri, i cili sigurohet pas datës së hapjes së ofertave, në respektim të parimit të barazisë, mosdiskriminimit, referuar nenit 3, pika 1 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.”.

Sa me siper bazuar ne konstatimet e sipercituara, kriteri 2.3.7 i kushteve te vecanta te kualifikimit konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “INA” SH.P.K, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “INA” SH.P.K, me Nuis J61814009W, skualifikohet.

II- Operatori Ekonomik “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur ne SPE nga Operatori Ekonomik rezulton se ky OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon pervojen e meparshme te ngjashme sipas percaktimeve ne kriteret e vecanta 2.3.1, te DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe

profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e **OE “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K**, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “2Z KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis J63229466K, skualifikohet.

III- Operatori Ekonomik “ASI-2A CO” Shpk, me Nuis K53002402C,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO X

Nisur nga njoftimi i APP në lidhje me përjashtimin e OE “ASI-2A CO” Shpk nga e drejta për të fituar kontrata publike si dhe bazuar në Buletinin Nr. 48 datë 3 Gusht 2026, ky Operator skualifikohet nga kjo procedure prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “NIEM” Shpk, me Nuis K36609610Q dhe me adrese Autostrada Bilisht Korce, Km. i 3, Qender Bilisht, Bitincke, Korce & “UDHA” Shpk, me Nuis K77524909Q dhe me adrese Lagjia “Pjeter Budi”, Rruga “Qamil Xhika”, Nderresa Nr.31 8001, Burrel, Diber, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 35,714,543 (tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e katërmbedhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) Lek pa Tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU